



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE**

**STATISTIKA MBI VEPRIMTARINË E
GJYKATËS KUSHTETUESE
PËR VITIN 2019**

2019

STATISTIKAT
PËR VEPRIMTARINË E GJYKATËS KUSHTETUESE GJATË VITIT 2019

Në përmbushje të detyrimeve ligjore për publikimin periodik të vendimeve, si dhe bërjen sa më transparente të veprimtarisë së saj, Gjykata Kushtetuese ka përgatitur raportin statistikor për vitin 2019. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj Gjykata është përpjekur të ruajë pavarësinë, paanësinë, integritetin dhe profesionalizmin si një parakusht për besueshmërinë dhe ndikimin e saj në jetën publike të vendit dhe ndërtimin e shtetit të së drejtës.

Prej datës 23 mars 2018 Gjykata Kushtetuese nuk e ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor për vendimmarrje për kalimin e çështjeve gjyqësore për shqyrtim në seancë plenare. Po ashtu, prej datës 16 korrik 2018 Gjykata Kushtetuese nuk e ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor edhe për vendimmarrje në kolegje. Me formimin e kuoromit për kolegje, në datën 14.11.2019, Gjykata filloi menjëherë nga procesi i shqyrtimit paraprak të çështjeve të regjistruara pranë saj. Gjatë kësaj periudhe të rinisjes së funksionalitetit, kolegjet e Gjykatës Kushtetuese janë shprehur me vendim për 40 kërkesa (vendime për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare); për 4 kërkesa kalimin e tyre për shqyrtim në seancë plenare; për 2 kërkesa shqyrtimin paraprak të tyre nga Mbledhja e Gjyqtarëve.


Sikurse do të konstatohet më tej edhe nga statistikat e detajuara dhe grafikët ilustrues përkatës, shumica e vendimeve kanë të bëjnë me ankimin kushtetues individual, i cili edhe pse vazhdon të fokusohet në procesin e rregullt ligjor, me ndryshimet e fundit kushtetuese është zgjeruar në favor të legjitimitit për paraqitjen e kërkesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ky zgjerim i ankimit kushtetues individual do të garantojë një mbrojtje më të madhe të individit ndaj akteve të pushtetit publik dhe në këtë drejtim pritet një shtim i numrit të kërkesave të kësaj natyre. Pjesa tjetër e vendimeve kanë të bëjnë me kërkesat që kanë si objekt shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën dhe zgjidhjen e konfliktit të kompetencave.

Përpara se të informojmë të dhënat statistikore për veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese gjatë vitit 2019, sjellim në vëmendje se në 1 janar 2020, numri total i kërkesave që ende nuk janë shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese është **85**.¹

A. KËRKESAT DREJTUAR GJYKATËS KUSHTETUESE GJATË VITIT 2019²


Në vitin **2019** në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë janë paraqitur dhe regjistruar në total **50 kërkesa**, nga të cilat:

- **29** kërkesa janë paraqitur për *kundërshtim vendimeve të gjykatave të zakonshme, në kuadër të procesit të rregullt ligjor*);
- **3** kërkesa janë paraqitur për *konstatim të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor*;
- **14** kërkesa janë paraqitur për papajtueshmëri të *ligjeve (apo dispozitave të veçanta të tyre)* me Kushtetutën;
- **1** kërkesë është paraqitur për *zgjdhje të mosmarrëveshjes së kompetencës*;
- **1** kërkesë është paraqitur për kundërshtim *vendimi të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë*;
- **2** kërkesa janë paraqitur për kundërshtim të *vendimeve të Këshillit të Ministrave*.




¹ Për shpjegime më të detajuara shih Rubrikën “Çështje të mbartura”

² Kërkesa të hartuara sipas kriterëve formale të parashikuara në nenin 27 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

 Sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese (sipas nenit 134 të Kushtetutës), gjatë vitit 2019 janë paraqitur:

- 1 kërkesë nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë;
- 1 kërkesë nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë;
- 7 kërkesa nga gjykatat (kontroll incidental);
- 1 kërkesë nga Organet e Qeverisjes Vendore;
- 3 kërkesa nga organizatat;
- 37 kërkesa nga individët;



B. VENDIMMARRJA E GJYKATËS KUSHTETUESE GJATË VITIT 2019

Gjatë vitit 2019 Gjykata Kushtetuese:

- ka kaluar **4 kërkesa** për shqyrtim në seancë plenare;
- ka kaluar **2 kërkesa** për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve;
- për **40 kërkesa** ka vendosur moskalimin e tyre për shqyrtim në seancë plenare (vendime moskalimi).



Referuar kërkesave të kaluara për shqyrtim në seancë plenare:

- 1 kërkesë është paraqitur nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë;
- 1 kërkesë është paraqitur nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë;
- 1 kërkesë është paraqitur nga gjykatë, në kuadër të kontrollit incidental, sipas parashikimeve të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës;
- 1 kërkesë është paraqitur nga individ.



Referuar kërkesave të kaluara për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve:

- 1 kërkesë është paraqitur nga organizatë (Shoqata e Bashkive të Shqipërisë);
- 1 kërkesë është paraqitur nga individ;



Referuar vendimeve të moskalimit:

Kolegjet e kësaj Gjykate janë shprehur me vendim për **40 kërkesa**, bazuar në nenin 31/a, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr.8577/2000). Nga këto, sipas rasteve dhe shkaqeve ligjore, të parashikuara në nenet 31/2, dhe 31/a/2, nga Kolegjet është vendosur për sa vijon:

- për **4 kërkesa**: “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, për shkak se kërkimet nuk hyjnë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese;
- për **6 kërkesa**: “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, për shkak se kërkesa nuk është paraqitur nga subjekti që legjitimohet;
- për **15 kërkesa**: “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, kur vërtetohet se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor;
- për **7 kërkesa**: “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, pasi kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, ose legjislacioni në fuqi parashikon mjete efektive në dispozicion;
- për **3 kërkesa**: “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, pasi kërkesa është


haptazi e pabazuar;

- për **1 kërkesë**: “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, pasi kërkimet të cilat nuk hyjnë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese; si dhe kur vërtetohet se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor;

- për **1 kërkesë**: “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, pasi vërtetohet se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor, si dhe kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, ose legjislacioni në fuqi parashikon mjete efektive në dispozicion;

- për **1 kërkesë**: “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, pasi kërkesa nuk është paraqitur nga subjekti që legjitimohet, si dhe është haptazi e pabazuar;

- për **2 kërkesa**: “Kthimin e kërkesës për plotësim”.



Nga totali i vendimeve të dhëna gjatë vitit **2019** (40 vendime):

- 30 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura në vitin 2018;
- 10 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura në vitin 2019.

C. ÇËSHTJE TË MBARTURA

- **8 kërkesa** janë të mbartura nga viti 2017, nga të cilat:
 - ◆ **5 kërkesa** kanë kaluar për shqyrtim në seancë plenare;³
 - ◆ **3 kërkesa** kanë kaluar për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.⁴

- **40 kërkesa** të mbartura nga viti 2018, nga të cilat:
 - ◆ **9 kërkesa** kanë kaluar për shqyrtim në seancë plenare;
 - ◆ **6 kërkesa** kanë kaluar për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve;
 - ◆ **25 kërkesa** janë në fazën e shqyrtimit paraprak nga Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese.

- **41 kërkesa** të mbartura nga viti 2019, nga të cilat:
 - ◆ **2 kërkesa** kanë kaluar për shqyrtim në seancë plenare;
 - ◆ **2 kërkesa** kanë kaluar për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve;
 - ◆ **37 kërkesa** janë në fazën e shqyrtimit paraprak nga Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese.

³ Shqyrtimi në seancë plenare i këtyre kërkesave do të bëhet në momentin që Gjykata Kushtetuese do të ketë kuorumin e nevojshëm për shqyrtimin e tyre në seancë, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 1 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

⁴Shqyrtimi paraprak i këtyre kërkesave nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese do të bëhet në momentin që Gjykata Kushtetuese do të ketë numrin e nevojshëm të gjyqtarëve për shqyrtimin e këtyre kërkesave, sipas parashikimeve të nenit 31/a, pika 1 të ligjit lartpërmendur.